



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2021:061392
Datë: 22.07.2024
Numri i dokumentit: 05962426

K.DH.SH.II.nr.869/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtari Ramush Bardiqi, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “Auto Mita” ShPK me seli në Prishtinë, ndaj debitorit Komuna e Mitrovicës, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1632/23 i datës 20.12.2023, me datë 22.07.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e debitorit Komuna e Mitrovicës, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1632/23 i datës 20.12.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike me aktvendimin KPPP.nr.1632/23 të datës 20.12.2023, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit Komuna e Mitrovicës i ushtruar kundër urdhrit për lejimin e përmbarimit numër P.nr.062/21 të datës 02.03.2021 të lejuar nga Zyra Përmbarimore – përmbaruesi privat Rrezarta Metaj dhe ka lënë në fuqi urdhrin përmbarimor P.nr.062/21 të datës 02.03.2021 të lejuar nga përmbaruesi privat Rrezarta Metaj.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me propozimin që aprovohet ankesa e debitorit Komuna e Mitrovicës së Jugut me seli në rrugën Bedri Gjinaj në Mitrovicë, të ndryshohet aktvendimi me numër KPPP.nr.1632/23 i datës 20.12.2023, i lëshuar nga gjykata Komerciale e Kosovës, në atë mënyrë që të anulohet Urdhri përmbarimor P.nr.062/21 i datës 02.03.2021 i lëshuar nga përmbaruesi privat Rrezarta Metaj, dhe rrjedhimisht hedhet poshtë propozimi për përmbarim i parashtruar nga kreditori “Auto Mita” ShPK, me seli në fshatin Preoc, Prishtinë, me numër unik identifikues 810616481

kundër debitorit Komuna e Mitrovicës së jugut, dhe të detyrohet kreditori “Auto Mita” ShPK me seli në fshatin Preoc, Prishtinë, që debitorit Komuna e Mitrovicës, t’ia paguaj shpenzimet për përpilimin e ankesës në vlerë prej 104 euro.

Dhomat e Shkalles së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

- Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori më datën 02.03.2021, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës nr.20-SHV01-IM4-662 të datës 01.12.2020, për shumën e përgjithshme prej 4,800.00€.

Përmbartuesi privat Rrezarta Metaj, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit ka lëshuar urdhër P.nr.061/21 të datës 02.03.2021 me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës nr.20-SHV01-IM4-662 të datës 01.12.2020, me të cilin është detyruar debitorit që të paguaj shumën e borxhit prej 4,800.00€, me kamatëvonesë prej 8% në vit, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore, ashtu që këto detyrime të realizohen përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorit, si dhe me regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe ta paluajtshme të debitorit dhe me shitjen e tyre të realizohet inkasomi i borxhit të kreditorit.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbartimit, brenda afatit ligjor, prapësim ka paraqitur debitorit, duke kundërshtuar propozimin e kreditorit si të pabazuar, me arsyetimin se propozimi për Përmbartim në bazë të dokumentit të besueshëm përkatësisht fatura nr.20-SHV01-IM4-662 e datës 01.12.2020, nuk është e përshtatshme për përmbartim. Gjykatës i ka propozuar që të aprovohet prapësimi i debitorit, ndërsa urdhri përmbartimor të anulohet.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike me aktvendimin KPPP.nr.1632/23 të datës 20.12.2023, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit Komuna e Mitrovicës i ushtruar kundër urdhrin për lejimin e përmbartimit numër P.nr.062/21 të datës 02.03.2021 të lejuar nga Zyra Përmbartimore – përmbartuesi privat Rrezarta Metaj dhe ka lënë në fuqi urdhrin përmbartimor P.nr.062/21 të datës 02.03.2021 të lejuar nga përmbartuesi privat Rrezarta Metaj.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e Shkalles së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur e ka refuzuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrin të përmbartuesit privat, me të cilin është caktuar përmbartimi i propozuar nga kreditori. Në arsyetimin e aktvendimit të kontestuar është theksuar qartë se në rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit

privat bazohet në dokumentin e besueshëm - përkatësisht Faturën Nr.20-SHV01-IM4-662 e datës 01.12.2020, e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këtë faturë, janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i faturës, si dhe është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjta është dorëzuar në origjinal, mban vulën e protokollimit nga ana e debitorit, si dhe nuk është kontestuar asnjëherë nga debitori.

Prandaj, bazuar në këto arsye, Gjykata e Shkalles së Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të bazuar në dispozita konkrete ligjore, ashtu që përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Shkalles së Dytë. Sipas kësaj gjykate, aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK dhe në konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së dytë analizoi pretendimet e debitorit me ankesë mirëpo gjeti se të njëjtat nuk janë të argumentuara me prova konkrete përmes të cilave do të vërtetohej e kundërta e asaj që është thënë në aktvendimin e kontestuar. Debitori me ankese ka paraqitë disa prova me pretendimi se paditësi ka bërë pagesën e faturës nr.20-SHV01-IM4-662 të datës 01.12.2020 në bazë të urdhërpagesë së datës 22.04.2022. Mirëpo nga shkresat e lëndës rezultojnë se debitori ka vepruar në kundërshtim me dispozitën e Nenit 180 par.1 të LPK-së, e cila përcakton se: *“Në ankesë nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të propozohen prova të reja, përveç se kur ankuesi jep prova se pa fajin e vet nuk ka mundur t’i paraqesë, përkatësisht t’i propozojë gjer në përfundimin e shqyrtimit kryesor në gjykatën e shkallës së parë”*. Debitori nuk i ka parashtruar këto prova në procedurën e zhvilluar në shkallë të parë, mirëpo këto provat i ka parashtruar vetëm në gjykatën e shkallës së dytë dhe nuk ka dhënë prova se pa fajin e vet nuk ka mundur t’i paraqesë, përkatësisht t’i propozojë gjer në përfundimin e procedurës në gjykatën e shkallës së parë. Megjithatë, në bazë të këtyre provave, përkatësisht nga kjo urdhërpagesë nuk mund të konstatohet fakti se kreditori e ka pranuar këtë pagesë në xhirrollogari bankare.

Gjykata, bëri shikimin e shkresave të lëndës, analizoi pretendimet e debitorit në prapësim, dhe vlerësoi se janë të paqëndrueshme dhe të pabazuara në ligj, për arsye se nuk ka ofruar prova në mbështetje të pretendimeve të tij siç është paraparë me nenin 69 par. 4 të LPP-së, se nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet ligjore për anulimin e Urdhrit të Përmbaruesit Privat apo shtyrjen e zbatimit të përmbarimit, të përcaktuara me dispozitat e nenit 61 par 1 pika 1 dhe nenit 71 par 1, pika 1 deri në 12 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (Ligji nr. 04/L-139), të Republikës së Kosovës.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË
Dhoma e Shkallës së Dytë
K.Dh.Shk.II.nr.869/24 dt. 22.07.2024

Gjyqtari,
Ramush Bardiqi